



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 30.11.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores për Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës **27.11.2023**, të parashtruar nga **Grup i OE MENTI SHPK & ENGINEERING GROUP SHPK**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Ndërtimi i QKMF ne Istog” me Nr. të Prok: 206-23-6380-5-1-2 nxjerr:**

V E N D I M

1. **REFUZOHET**, si e pa bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e **Grup i OE MENTI SHPK & ENGINEERING GROUP SHPK** e dt. 27.11.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit **“Ndërtimi i QKMF ne Istog”** me Nr. të Prok: **206-23-6380-5-1-2** kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK, të datës 20.11.2023.
2. Mbetet në fuqi Njoftimi mbi Vendimin e AK, i datës 20.11.2023.
3. Autoriteti Kontraktues, vazhdon me aktivitetin e prokurimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Grup i OE MENTI SHPK & ENGINEERING GROUP SHPK me datën 27.11.2023 ka parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Ndërtimi i QKMF ne Istog”** me Nr. prokurimi **206-23-6380-5-1-2**. Autoriteti Kontraktues, me datë 30.11.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga AK sipas OE ankues:

Lpp- neni 1 – Qëllimi , paragrafi 1 , 2 dhe 3

Lpp- neni 4 – Përkufizimet , paragrafi 1.36 dhe 1.75

Lpp- neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti , paragrafi 1

Lpp- neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi paragrafet 1 , 2 , 3 , 4 dhe 6.

Lpp- neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve paragrafi 2 dhe 4

Lpp- neni 64 - Dëshmit e kërkesave

Lpp- neni 65 - Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve paragrafi 4.11

Lpp-neni 69 - Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale paragrafi 4 (nenparagrafet 4.1, 4.2, 4.3 dhe 4.4) , paragrafi 5 dhe paragrafi 6)

Lpp-neni 70 - Standardet për Sigurimin e cilësisë

Lpp-neni 71 – Grupet e Operatoreve Ekonomik

Rrpp neni 27 paragrafi c)

Lpp-neni 72 - Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

Rrpp neni - 39. Sqarimi i Tenderëve paragrafi 39.4 dhe paragrafi 39.8

Rrpp neni 11 - Funksionet e Departamentit /Njësisë së Prokurimit : pika g) , h), i) .

Pergjigjia e Autoritetit Kontraktues ne lidhje me pretendimet Ankimore te OE ankues:

Nuk qendron pretendimi juaj rreth diplomave te Nostrifikuara per GOE AAG Projekt – Shkemi – Enggrup – Alping dhe per Alfa I, meqense ne NJK dhe ne DT eshte kerkuar deshmia: **Diplomat e noterizuar (fakulteti sipas sistemit 5 vjeçar ose master)**, e nuk eshte kerkuar qe diplomat te jene te nostrifikuara.

Nuk qendron pretendimi juaj se GOE Termomontimi – 100% Design – Haxha Kom – Rexha, se nuk e kane plotesuar inxhnierin per Efijence te energjise, pasi qe ne oferte ky GOE ka ofruar deshmita per z. Afrim Prokshi, ne mesin e te cilave edhe kontraten e cila pershfine tere vitin 2023 dhe **me mundesi vazhdimi**. Ne baze te dokumentacionit te ofertes deshmohet se Inxh. i Elektroteknikes z. Afrim Prokshi, qe nga viti 2014 punon ne kompanine Termomontimi SHPK dhe ka nje CV mjaft te pasur te projekteve me kete kompani, andaj kontrata eshte e vlefshme meqense hapja e ofertave eshte bere me daten 24.07.2023, ndersa kontrata eshte nga data 04.01.2023 deri me 31.12.2023 **me mundesi vazhdimi**. Ne NJK dhe ne DT eshte kerkuar deshmia: **Kontratat e punës me punëdhënësin ose marrëveshjet mbi angazhimin për këtë projekt**, e nuk eshte kerkuar qe Kontrata e punës te jete per tere afatin e projektit.

Nuk qendron pretendimi juaj se GOE AAG Projekt – Shkemi – Enggrup – Alping, nuk e kane plotesuar pajisjen e kerkuar Vibrator, meqense ne oferten e tyre kane ofruar nje liste te madhe te pajisjeve te anetarit te konsorciumit Shkemi SHPK, ne mesin e te cilave nr. 55 eshte edhe vibrator betoni i deshmuar me faturen me poshte:

Fatura 028177

02.06.2023

N.T. KLI- PRIZREN (Emri dhe adresa e shitesit)

600065818 (Numri fiskal i shitesit)

SHKEMBI SHPK (Emri dhe adresa e bleresit)

600143614 (Numri fiskal i bleresit)

Nr. ren.	Pershkrimi i mallrave dhe i sherbimeve	Njes. mat.	Sasia	Grani per nesi pa TVSH Euro	VLERE Euro
1	VIBRATOR PER LLING I FERD	qg	1	296.61	296.61
2					
3					
4					
5					
6					
7					
8					
9					
10					
11					
12					
13					
14					

Gjithsej pa TVSH: 296.61

TVSH 18%: 53.39

TVSH 8%: 23.96

TOTALI per pagese: 350.00

Fatura e paguar

SHKEMBI SHPK

02.06.2023

Nuk qendron pretendimi juaj se GOE Construmax – Top Projekt – Harst Group, ne lidhje me afatin e kontrates per z. Bekim Rexhepi dhe z. Shaban Krasniqi, meqense te dy kontratat jane te vlefshme, hapja e ofertave eshte bere me daten 24.07.2023, ndersa kontrata per z. Bekim Rexhepi eshte deri me daten 24.01.2024 ndersa per z. Shaban Krasniqi deri me 31.12.2023 **me mundesi vazhdimi.**

Inxh. i Ndertimrarise z. Shaban Krasniqi eshte pronar i kompanise Top Projekt, andaj kontrata nuk kontestohet tek pronaret e kompanise. Ne NJK dhe ne DT eshte kerkuar deshmia: **Kontratat e punës me punëdhënësin ose marrëveshjet mbi angazhimin për këtë projekt**, e nuk eshte kerkuar qe Kontrata e punës te jete per tere afatin e projektit.

Pajtohem me disa nga pretendimet tuaja ne lidhje me oferten e GOE Hidro Projekt & Engrup, kjo oferte pas rivleresimit eshte trajtuar si e papergjegjshme dhe pretendimet e juaja vetem i fuqizojne mangesite e kesaj oferte. Sa i perket shfrytezimit te pajisjeve te Benita Company, ne kete rast nuk bie ndesh me ligjin meqense Benita eshte nenkontraktor i Hidroprojekt e nuk eshte anetar i konsorciumit, por marrveshja mes tyre eshte vetem per furnizim me beton e jo per shfrytezim te pajisjeve te kerkuara. Sa i perket inxh. te Makinerise z. Ramadan Gashi, pajtohem se Kualifikimin si master e ka me 16.01.2020 dhe nuk e ka eksperiencen e kerkuar prej 5 vite pervoje pune pas diplomimit.

Çeshtja e nenkontraktoreve ka qene e sqaruar me heret ede nga ana e KRPP-se, shih sqarimin:

50. 20.02.2017. A kanë te drejtë qe dy apo me shumë ofertues te paraqesin te njëjtin nënkontraktorë për të njëjtin aktivitet te prokurimit?

Rregulla për nënkontraktimin përcaktojnë neni 30 i këtij ligji dhe neni 18.13 i Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik.

Operatori ekonomik që shpërblehet me kontratë mbanë përgjegjësinë e plotë për përmbushjen e kontratës në pajtim me kontratën pavarësisht që ndonjë pjesë nënkontraktohet të palët e treta. Nënkontraktimi nuk bënë të tejkalojë 40% të vlerës totale të kontratës. Secili nen-kontraktor i propozuar duhet te përmbush kërkesat e përshtatshmërisë dhe duhet te dorëzoj dëshmitë mbi përmbushjen e kërkesave të përshtatshmërisë. (neni 18.13 i Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik).

Është obligim ligjor (neni 30 i LPP) qe secili ofertues duhet të tregoj në tenderin e tij:

- çdo pjesë të kontratës që OE ka për qëllim të nënkontrakttoj te palët e treta; dhe
- secilin nënkontraktues të propozuar.

Si rrjedhojë, KRPP konsideron se **dy apo me shumë ofertues mund të paraqesin të njëjtin nënkontraktor.**

Nuk qendron pretendimi juaj ne lidhje me sqarimet e bera rreth certifikatave ISO, pasi qe ne fazen e pare te vleresimit komisioni ka kerkuar sqarime shtese ndaj tre ofertave ne lidhje me certifikatat ISO 9001, 14001, 45001 te cilat kane qene te plotesuara nga grupi i OE po jo edhe nga secili anetar i GOE.

Vitet me heret certifikatat kerkoheshin qe te plotesohen vetem nga GOE, por bazuar ne nenin 26 te Rregullores Nr. 001/2022 per Prokurim Publik, duhet qe secili anetar ti plotesoj ato, andaj per shkak se shume OE mund te mos e dine kete dispozite ka qene e nevojshme qe te kerkohen sqarime shtese.

Ndërsa ju ne ofertën tuaj i keni ofruar ISO certifikatat dhe nuk kemi pasur nevojë te ua kërkojmë.

Sa i përket përket pretendimet se operatore tjerë kane përfshirë ne lista punëtor fiktive qe punojnë jashtë vendit, ne si AK nuk kemi mundësi qe ti vërtetojmë për secilën oferte nga 40 punëtor te ofruar se ku gjenden brenda apo jashtë vendit, por ne vlerësojmë ne baze te dokumentacionit. Listat e ATK-se nuk kane qene kërkesë e DT dhe ka vite qe për listat e ATK-se KRPP rekomandon qe mos te kërkojen, për shkak te pamundësisë se OE qe ti mbajnë stafin vazhdimisht te angazhuar, kur nuk kane pune.

Ndërsa certifikata për efikasitet të energjisë, ka qene qartë e specifikuar ne NJK dhe DT, kërkesa 3 te Kapaciteti teknik dhe profesional, dhe si e tille është dashtë te plotësohet nga secili ofertues ose GOE.


AK mbetet pas vendimit te datës 20.11.2023, sipas te cilit ju nuk e keni plotësuar kërkesën për stafin teknik min. 40 punëtor sipas dëshmimeve te kërkuara. Ju si lideri i konsorciumit Menti Sh.p.k. i plotësoni me dëshmi 20 punëtor, kontratat e punës për 7 punëtor janë me data te skaduara 31.03.2023 d.m.th. para hapjes se tenderit. Anëtar i konsorciumit Engineering Group SH.P.K. i plotëson me dëshmi 8 punëtor. Gjithsejtë me dëshmi oferta juaj e plotëson numrin e stafit teknik vetëm për 28 punëtor.

AK mbetet pas vendimit te datës 20.11.2023, sipas te cilit ju nuk e keni prezantuar Inxhinierin me Certificate te efiqences se energjisë sipas kërkesës 3 te Kapaciteti teknik dhe profesional - nuk keni ofruar asnjë dokument për dëshmi.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**



Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit